



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr.55, datë 28.10.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 28.10.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e projekt vendimit "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Elbasan sh.a.",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Elbasan (**UK Elbasan**) me shkresën nr. 1764 prot. datë 30.07.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor të UK Elbasan në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
 - a) Shoqëria UK Elbasan ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 157 349 banorë në Bashkinë Elbasan;
 - b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Julian Doçi zotëron diplomë master në Inxhinieri hidroteknike marrë në mars të vitit 2011 dhe ka 8 vite përvojë në profesion.

4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit dhe ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Elbasan, të:

- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
- b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (*ligji nr. 9121*) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, rekomandon:

- Shoqëria UK Elbasan duhet të aplikojë pranë ERRU për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me një strukturë të re tarifore;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Elbasan është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime UK Elbasan sh.a me NUIS L43121201L në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime UK Elbasan sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues Ligjor - z. Luan Dervishi
 - b) Drejtues Teknik - z. Julian Doçi
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime UK Elbasan sh.a është:

Bashkia Elbasan
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime UK Elbasan sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime UK Elbasan sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI